



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:051472

Datë: 17.01.2020

Numri i dokumentit: 00768549

P.nr. 1114/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE -DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM NË PEJË, me gjyqtaren Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Zelfije Prekaj si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj te pandehurit Sh. Q. nga, për shkak të veprës penale te kanosjes nga neni 185 par. 2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore -Departamenti i përgjithshëm ne Pejë, PP.II-nr. 674/16 dt.06.10.2016 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurorit të shtetit Suada Hamza, të akuzuarit Sh. Q., mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. Zeqir Bërdynaj, të dëmtuarit H. Z. dhe përfaqësuesit të tij të autorizuar av. Gezim Kollçaku, me dt. 17.12.2019 mori dhe me dt. 13.01.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari Sh. Q.i biri i I. dhe nënës F. e gjinisë Z. i lindur me dt në fsh. K-....., ku edhe tani banon i martuar, baba i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, gjendjes së mesme ekonomike, më nr. personal dhe me nr. tel., egjiptian, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

-Për shkak se:

Që nga muaji gusht i vitit 2016 e gjerë me dt. 15.06.2017 rreth orës 20.30 minuta në fsh. K Pejë, pikërisht në shtëpinë e të dëmtuarit me qëllim të frikësimit, përmes letrave me përmbajtje kanosëse seriozisht kanos te dëmtuarin H. Z. në atë mënyrë që i pandehuri i dërgon të dëmtuarit tek dyert e oborrit te shtëpisë së tij letra me fjalë kanosëse “se ki me u likvidu ti me anëtarët e familjes tande” dhe sipas një letre tjetër të dërguar “këna me ta marr shpirtin” t; cilat veprime t; pandehurit tek i dëmtuari kanë shkaktuar frikë, pasiguri se me të vërtetë do i ndodh diçka e keqe nga i pandehuri.

Me çka ka kryer vepër penale të Kanosjes nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7,41,43,46,49,50,51, 52,73, të KPRK-së, dhe nenit 185 par. 2 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin:

E GJYKON

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj, i cili nuk do t; ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda periudhës 1 (një) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore gjykatës ti paguaj shumën prej 50 euro, në emër të paushallit gjyqësor gjykatës të ia paguaj shumën prej 30 €, dhe shumen prej 30 euro në emër të kompensimit për viktimat e krimit, në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Pala e dëmtuar H. Z. nga fsh.K ..., për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP.II-nr. 2448/17 me dt. 30.10.2017, kundër të akuzuarit Sh. Q., për shkak të veprës penale te kanosjes nga neni 185 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor, në të cilin e ka njoftuar të akuzuarin lidhur me të drejtat e tij konform nenit 323 të KPPK-së, i akuzuari ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe pas kësaj gjykata ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor me fjalën hyrëse pastaj procedurën e provave.

Në procedurën e provave gjykat ka dëgjuar të dëmtuarin H. Z. në cilësi të dëshmitarit dëshmitaret: M. Z., polici hetues S. H., A. A., N. K., A. Z., dhe janë lexuar këto prova materiale: Raporti fillestar incidentit 2017-DA-1234 i dt. 12.07.2017, raporti i policor H. K. i dt. 16.06.2017, deklarata e të dëmtuarit H. Z.e dhënë me dt. 16.06.2017 ne fsh. si dhe 24.06.2017 në Stacion Policor në Pejë, deklarata e të pandehurit e dhënë në polici 20.06.2017 dhe 13.10.2017, deklarata e të dëmtuarit e dhënë në prokurori me dt. 27.10.2017, letrat me dorëshkrim dhe atë gjithsejtë 8 letra, raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë e dt. 10.10.2017 si dhe dorëshkrimet e marra nga i pandehuri Sh. Q. dhe atë 8 dorëshkrime bashkë me formularin, peticioni me nënshkrime të fshatarëve nga bashkëfshataret e të akuzuarit nga fsh., Deklarata e të dëmtuarit H. Z.e dhënë ne shqyrtim gjyqësor te dt. 16.10.2018., Deklarata e ekspertës së forenzikes L. Sh. e dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt. 08.01.2019, Deklarata e Dëshmitarit M. Z. e dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt. 06.02.2019, Deklarata e policit hetues – dëshmitarit S. H. e dhënë në shqyrtim gjyqësor te dt. 06.02.2019, Deklarata Dëshmitarit N. K. e dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt. 26.03.2019, Deklarata Dëshmitarit A. A. e dhënë në shqyrtim gjyqësor te dt. 26.03.2019, Deklarata e dëshmitarit M. Z. e dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt. 26.03.2019, ekspertiza e grafologjisë e dt. 08.08.2019 si dhe 8 dorëshkrime te marra si mostër nga i pandehuri ne gjykata me dt. 12.06.2019, është shikuar foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe se fundi është dëgjuar mbrojtja e të akuzuarit.

I dëmtuari H. Z. në shqyrtim gjyqësor të dt.16.10.2018 ka deklaruar se te akuzuarin e ka djalin e halles, raportet me te nuk I ka pas te keqija, janë le dhe rritur bashke ne nje bukë, per interesa ka ardhur çështja e tokës dhe e vllalznive të tij përkatësisht kushërivë që ky i ka dhëndurë. Kushërinjtë e tij e kanë qit tokën me shit duke menduar se ky e ka qit shenjen për shitje, i kanë qu fjalë i kanë thënë se ka qenë njeri në bagrem dhe ka deshtë me te vra. Kur ky e ka pyet se

kush ai i ka thënë se nuk mundet me të tregu se tani i duhet me lëshu fshatin. Meqenëse nuk i ka treguar ky i ka thënë se je tu gënjye. Atë ditë ky nuk ka qenë me vendosur shenjen për shitje sepse ka qenë tu punu tu i vozitë nxënësit. Të nesërmen kanë filluar letrat kërcënuese dhe nuk janë ndal. E ka pyet djalin e mixhës dhe i ka thënë se është i interesuar ta gjej se kush është. I njëjti ka pas qëllim me i frikësuar që pastaj ky të bëjë çfarë të dojë me tokën në fjalë, prej që e ka lajmëruar rastin janë ndërprerë edhe letrat.

Edhe në deklaratat e dhëna në Stacion policorë në Pejë me dt.24.06.2017 dhe me dt.16.06.2017 dhe në prokurori me dt.27.10.2017 ka deklaruar po thujse në mënyrë të njëjtë.

Ekspertja *L. Sh.* para gjykatës me dt. 08.01.2019 ka deklaruar se ekspertizat bëhen me urdhëresë te gjykatës ose prokurorisë varësisht nga ajo që u sjellët edhe bëjnë edhe ekzaminimin dhe bazuar ne prova- dëshmitë që i kanë në dispozicion. Nuk është pjesë e punës së tyre që të marrin provat – dëshmitë apo mostrat dëshmitë që i ka pas i ka përshkruar ne ekspertizë në faqen 2. Në baze të ekspertizës që e kanë bërë është konstatuar se shkronjat e shtypit te evidentuara në dëshminë 1 në faqet e emërtuara në numrin rendor 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe krahasimet mostrat eksperimentale te evidentuara në dëshminë 2 janë identifikuar karakteristikat e përgjithshme dhe individuale që përputhen ne mes veti. Në raport janë paraqitur edhe gjetjet në përputhje me shkrimet. Në raport ne faqen 3 të raportit janë shënuar edhe disa karakteristikat që nuk janë përputhur. Në dëshminë 1 konkretisht ne faqet e emërtuara me numrin rendor 13 dhe 14 dhe krahasimet me shkrimet me mostrat eksperimentale te evidentuara në dëshminë 2 nuk janë identifikuar karakteristika të përgjithshme dhe individuale që përputhen ne mes veti. Letrat që i ka pas si dëshmi të evidentuara në numrin 1 kanë qenë 8+2 që gjithsejte janë 10. Mirëpo kanë ardhur tek përfundimi se janë 14 faqe sepse ka pas letra me ka 2 faqe. Fillimisht shkrimet i kanë klasifikuar në të shkrimit-dorës dhe të shtypit. Faqet prej 1-12 janë përputhur me dorëshkrimet e të akuzuarit ndërkaq 13 dhe 14 nuk janë përputhur. Faqe 13 dhe 14 janë letra të ndara. Se si merren dëshmitë është e përcaktuar ne udhëzues dhe është shpërndarë tek hetuesit dhe prokuroria, nuk është e përcaktuar se kush i merr mostrat dhe secili person që është hetues në rast ose prokuror mund ti merr mostrat dhe te gjitha mënyrat e marrjes së dorëshkrimit janë të përcaktuara në udhëzues, se si janë marr këto mostra nuk mund ta din.

Dëshmitari *M. Z.* ne seancën e shqyrtimit gjyqësor te dt.06.02.2019 ka deklaruar se Palët ne procedurë i njeh mirë, më parë nuk kanë pas mos marrëveshje ne mes veti raportet i kanë pas të mira. Ka njohuri se janë gjuajtur letra anonime në oborrin e shtëpisë së H., i ka thënë vet H., me Sh. nuk ka bisedu për këto letra, kur ka ardhur letra në oborr të vëllait A. ja kanë qu H.. Të dytën e kanë gjet fëmija dhe atë letër e ka parë ka qenë pa zarf e kahap. Nuk ka mujt me nxjerr shkrimin e ka parë se janë letra kërcënuese dhe ia ka qu H.ë sepse letra e ka pas emrin H. Z.. Ka qenë tek H. për shkak se e ka dërguar Sh. me i thonë që të ketë kujdes dhe të ruhet se katundi nuk po folin mirë për të. Mirë është me shku me i thënë, ky nuk e ka marr aq serioze por ka menduar se të vetin duhet ta ruaj. Kjo ka qenë para se fëmija ti gjejnë letrat dhe të dërgohet letra në oborrin e vëllait tim për shkak se nuk kam qenë në dijeni se më përpara janë gjuajt letra. Se pari e kam kuptuar për letra kur janë gjetur letrat siç e cekta me përpara, nuk i ka thënë H. se kanë me të vra. Nuk i ka thënë H. se njeri që ka dashtë me të vra ka qenë vjerrun ne banderë, ai me ka thënë se ka shku me bisedu me Sh. dhe Sh. i ka thënë se njeri që ka deshtë me të vra është vjerrun në bander. Nuk ka qenë më H. prezent për ta ditë se çfarë i ka thënë Sh., nuk ka njohuri se kush i ka qu ato letra dhe kish pas dëshirë me ditë se kush i ka qu. H. e ka afër më shtëpi, letra e parë është gjetur tek dyert e oborrit te vëllait të tij ka qenë në zarf nuk e ka hap i ka thënë qojani H. sepse ka qenë emri i tij. Ndërkaq letrën tjetër e kanë gjetur fëmija dhe ka qene pa zarf. Në fillim ka pas disa kërcënime nga ana e H.ë kur i ka thënë se Sh. e ka të

ndaluar Kur i ka thënë H. se ka qenë Sh. tek ky, atëherë H. e ka lajmëruar menjëherë rastin ne polici dhe ka thënë se Sh. po e kërcënon. Aty konsideroi se nuk ka pas kërcënim për shkak se Sh. ka ardhur tek unë si mysafirë. E njeh dhëndërinë e H., ka pas tokë në, nuk e di se a ka dashtë dikush me shit atë tokë nuk kam njohuri dhe është e vërtetë se dhëndëri i H.ë deri ne luftë ka jetuar ne

Dëshmitari – polici hetues *S. H.* ne shqyrtimin gjyqësor të datës 06.02.2019 ka deklaruar se lidhur me këtë rast ka ndër marr disa veprime hetimore. Në polici punon që 19 vite në njësitin e Hetimeve ne Stacion policor në Pejë, 16 vite si policë hetues. Të akuzuarin e ka marr në pyetje, një herë në cilësi të dëshmitarit pastaj në cilësi të pandehurit, për shkak se viktimja ka dyshuar në të akuzuarin dhe sa e mban mend e ka pas të afërt. Hera e dytë ka qenë se viktimja ka thënë se dyshon në të akuzuarin sepse e ka edhe të afërt, sepse viktimja i duket se i ka thënë se ka biseduar në shtëpinë e të dyshuarit, letrat i ka pas si dëshmi dhe ky e ka marr mostrën me procedurë dhe në konsultim me prokurorin ka pas obligim mi marr mostrat sipas ligjit por në disa fletë. I kujtohet mostrat janë marr edhe me të shkrimet edhe me të shtypit mirëpo nuk më kujtohet se cilat janë marr me përpara. I kujtohet se e ka njoftuar të dyshuarin se me urdhër te prokurorit e kemi këtë urdhër me i marr shkrimet, e kemi njoftuar se nëse je ti dalin nëse nuk i ki bërë ato shkrime nuk del i njëjti me bindje na ka thënë se nuk i ka bërë. Ne formualr është e shënuar si merret mostra, formulari është i formuar nga Forenzika dhe secili formual shkruhet se si duhet te merret mosta, tekstin kryesisht është marr nga fjalët që kanë qenë të shkruara në letra, unë i kam marr letrat që i ka prezantuar i dëmtuari dhe ky i ka shkruar disa nga ato fjalë, kanë qenë 8 letra të ndryshme dhe ka prej atyre letra që janë të shkrimit dhe të shtypit. Mostrat janë marr me të shkrimit dhe shtypit, pozita që ka shkruar ka qenë pozita që ka dëshirua këtu i dyshuari, unë e kam lënë të lirë të akuzuarin dhe ai të përcakton pozitën si duhet te shkruaj. Personi që është i ngarkuar me rast ai që e heton rastin ai duhet te merr nënshkrimet, ekip te veçantë që është e specializuar për marrjen e shkrimeve, nënshkrimeve apo dorëshkrimeve për ekzaminim nuk e din a ka, ekziston forenzika, mirëpo për marrjen e shkrimeve apo nënshkrimeve nuk e di por çdo herë i marrin hetuesit.

Dëshmitari *N. K.* në seancën e shqyrtimit gjyqësor te dt. 26.03.2019, e kanë nënshkruar një petition i njehë Sh. dhe H.. Është i njoftuar me letrat që ju kanë gjuajtur H. ne oborrin e shtëpisë së tij, Sh.e ka shokë dhe komshi dhe i ka treguar për letrat, nuk i kujtohet përmbajtja e tyre, është fakt se letrat ekzistojnë mirëpo mendoi se nuk janë prej Sh.t, ato dikush i ka shkru por as H.nuk e din se kush i ka shkru. Si fshat e kemi marr iniciativë dhe ka shkruar petition se Sh. nuk është i involvuar në këto sene. Këtë e thotë se beson shumë se që nga viti 1999 e njoh Sh.me familje dhe e njoh edhe rrethin e tij dhe dajët e tij e po ashtu edhe H.e njehë. Sa e di përderisa ka ndodhur ky rast këta nuk kanë pas asnjë të keqe dhe në bazë të kësaj këta nuk kanë pas asgjë në mes veti. Dhëndurët e H. i njeh A. dhe B. , të njëjtit i ka komshi qysh para luftës, gjatë luftës ata kanë qëndruar e këta janë tërheqë. Këto letra ka mujt me i shkru i dhe me ja qit ne oborr. Peticionin e kanë shkruar për me garantu për Sh.si është sjell si komshi dhe nuk e di asnjë te keqe prej këtij njeri. Raportet janë prishur kur ky e ka lajmëruar policinë atëherë janë prish raportet. Më shumë rri me Sh.sepse e ka kojshi. Dhëndri i tij nuk ka ardhur asnjëherë në fshatë pas luftës, ata e kanë një tokë aty. Një vëlla i tij e ka punuar një pjesë të tokës tash e punon H. Q. dhe mbas luftës shtëpia e dhëndrit këtu të dëmtuarit nuk është djeg dhe kanë ndejt shumë njerëz aty. Nuk e di se a ka dal në shitje ajo pronë, nuk e din toka e B. t a ka dal në shitje dhe toka e A.t, B. t, H. janë në bllok. Gjatë vozitjes e kam parë se toka është në shitje mirëpo pastaj është hek mo nuk ka ekzist. Ka njohuri se është bërë ekspertiza grafologjike dhe janë dal se në ato letra janë shkruar nga Sh. jo krejt jo po 3-4 shkronja. Gjatë luftës nuk e di kur ka ik por e di H. ka qenë kryetar i fshatit për ashkali.

Më tutje ka deklaruar se nuk është e vërtetë që Sh. i ka thënë “ruju se o kon njeri në bagrem dhe ka dashtë me të vra por për hir temin nuk të ka vra”, dhe sa e di aty nuk ka bagrema, nuk e din pse o heq tabela për shitje. Sh. se a i ka thënë ti diçka me Shkrim H. se du me ditë çka i ka thënë ai iu ka përgjigj se ja ka thënë për të mirën e tij, ai i ka thënë se veq me gojë i ka thënë dhe këtë ja ka thënë nëpërmjet të kushërinjve të tij pastaj H. ka shkuar tek Sh.. Ka njohuri se mbas lufte ne fshatë është diskutu se A. dhe B. kanë bashkëpunua me serb shtëpitë e tyre unë kanë qenë të kallura, e B. t është djeg mbas lufte por unë nuk e di se dikush ka pretendime me ja marr toke a që kanë punu me shkije mirëpo personalisht e ka hek një letër që shkrujke serbisht në këtë “shtëpi mos e prek”.

Dëshmitari A. A. ne seancën e shqyrtimit gjyqësor te njëjtës datë ka deklaruar se Sh.e njoh prej si ka qenë fëmijë e ka komshi është njeri i mirë nuk i bënë dëm kërkujt, nuk e ngucë akënd, H.e njoh si dajën e Sh.t. Raportet i kanë pas të mira në mes veti, tek Sh. kam nejt edhe me H.ë, çka kanë në mes veti nuk e di. Është e vërtet se kanë shkruar peticion se Sh. nuk i bon këto sende. Ka dijeni që janë gjuajt letrat në oborrin e H.ë,

A kanë vazhduar kontaktet mbasi që jan gjuajt letrat, nuk e di më çfarë raporte kanë ne mes veti. Dhëndurët e H.ë kanë tokë në fshatin e juaj, dëshmitari deklaroi se po A. dhe B. nuk e di ndoshta ka pas tabele për shitjen e tokës. Ata i ka njfot i ka pas kojshi ata kanë qenë në luftë kanë ndejt aty dhe kanë qenë të veshur në paramilitar dhe kanë ndejt në fshatë para luftës, kur janë kthyer në shtëpi është gjetur një letër se mos e prek është shtëpi e magjupit mos e kall. Letra ka qenë e shkruar në gjuhën shqipe, ky personalisht nuk e ka pa por njerëzit me kanë thënë se ka pas letër. Ka dëgju se Sh. i ka thënë H.ë se mos i bjer dhëndurët se nuk janë të përshtatshëm për fshatin por i njëjti e ka marr në të kundërtën. Këto fjalë prej kujt i ka dëgjuar, prej Sh.t kur ai u ka treguar kur mblidhemi në kohë të lirë dhe fjalët Sh. u ka thënë se përmes një dajës M.ia ka qu këto fjalë. Gjatë luftës R. K. kanë pasë shumë vëllezër dhe e kanë pas shtëpinë në por të njëjtit kanë qenë kriminel dhe kanë punuar edhe me naftë me ta ka bashkëpunuar A., B. dhe H.. Dhe krejt fshati e dinë se H. ka shit naftë në luftë dhe për mos me e nguc shkijet H. shpesh e ka vesh edhe uniformën.

Dëshmitari M. Z. në shqyrtimin gjyqësor të dt. 06.02.2019 ka deklaruar se e njeh Sh.n, e ka komshi kanë qenë në shkollë se bashku, ia njohë familjen, asgjë te keqe nuk e di prej anës së tij. Raportet ne mes vete i kanë pas të mira, po ashtu edhe H.ka pas Respekt në katund tani si dajë i Sh.t. Ka dijeni për disa letra që janë gjuajt anonime që janë gjuajt në oborr të H., dëshmitari deklaroi se nuk e di se si janë shkruar letrat deri tek ai, por e di se janë gjuajt në bazë të Sh.t që na ka thënë se janë gjuajt në oborr te dajës së tij. Nuk ka njohuri se kush ka mujt me i shkru këto letra, dëshmitari deklaroi se jo nuk e di, ka shkruar peticionin per Sh.dhe e kemi shkruar për shkak se e njohim Sh.n, ka njohuri se Sh. i ka thënë H. se mos i bjerë do njerëz në shtëpi se sherri i tyre ki me honger dhe është për shkak të dhëndurëve. Sa e di unë këto fjalë i ka qar nëpër mjet M.dhe është fjala për A.dhe M.arsyeja ka qenë për shkak se kanë qenë bashkëpunëtor të serbeve dhe kanë qenë të veshur me uniform te tyre. Nuk e di se a din se është dal toka në shitje e B. t dhe A.t, nuk kam parë pllakë për shitje. Sh. i ka treguar se disa letra janë gjuajt në oborrin e H.ë dhe se letrat kanë qenë kërcënuese. Nuk e di kush i ka gjujt.

Mbrojta e të akuzuarit

I akuzuari Sh. Q.ka deklaruar se ka qenë në njohuri për këto letra një jav para se të lajmërohet rasti nga A. Z. nga djali i axhës së të dëmtuarit. Kanë qenë duke shkuar përku meka thënë A. a mos ki pas mysafirë prom, më tha se ka deshtë me ardhur H. me vëlla, dhe më tha për një letër sipas tij që nuk ishte e lexueshme, unë i thash se nuk paskam ndi ai me tha se kjo nuk

ishte e para, më tha se një është gjuajt tek shtëpia e tij dhe një tek shtëpia e vëllait të tij ne emër te H.ë, i ka thënë po me vjen keq çka e paska ndodhur kjo me pas mundësi me nxon edhe unë do ti ndihmoj. Mbas 1 javë 15-16 qeshor kam qenë në arë duke punuar terfoj H. ka ardhur tek nëna ime dhe i kanë thënë se ta kemi lajmëruar djalin në polici se mi kanë gjuajt këto letra dhe e din ai kush i ka gjujt, ka ardhur djali dhe e ka thirr unë i thash pritem 10 min derisa te vijë me bicikletë me thanë se nuk dojnë me të prit, i thash a jon me ker tha po mirëpo ata nuk më kanë prit dhe janë shku. Te nesërmen kam shkruare prapë në arë, një shitës i fshatit F. R. dhe ka shku tek shpija e tij dhe e ka pyet për letra, dhe vet F. me tregoj per këtë punë, djali i dajës tim i ka thënë se këtë prej fshatit nuk e ki. Pasi që është lajmëruar rasti ka ardhur M. Z. djali i axhës së tij me ndejt me familje, u bisedu ne fshatë se po vinë e po rrinë A. dhe B. Q. dhe po rrin te H., dhe kjo nuk është ne rregull sepse ata kanë ndejtur me shkije dhe kanë ikur bashkë me ta, kjo është biseduar në shitore, më kanë pyet se a mos e ki qit tokën në shitje me kanë pyet për tokën time tokën e A.t dhe B. t dhe H. sepse e kishin parë një tabel Toka në Shitje, unë atë tabel nuk e kam aprë dhe kur kam shkuar tek arat tabel nuk ka pas, në bazë të M. Z.i kam qu fjalë H.ë dhe i kam thënë ruju se je ka i man këta njëres dhe nuk po flitet ne fshat mirë për ty, sepse po i mban njerëzit që janë bashkëpunëtor me serbët dhe nuk janë të mirëseardhur ne fshatin tonë për shkak të bashkëpunimit me Paramilitarët. M. me ka treguar se kur i ka thënë ato fjalë ky ka sharë, mbas një javë ka ardhur me nënë e tij më ka thënë a me ki qu fjalë për M. i thash po dhe i thash te njëjtat fjalë, ky insistojke tregoma njërin se unë i tregoj atij, unë i thash nuk ki punë me një njeri por me një fshatë, H. ka shkuar. A. dhe B. që janë djemt e mixhës tim dhe janë dhëndurët e H.ë prej mbas luftës çdo mbledhje të fashtit janë biseduar se të njëjtit nuk janë të dëshirueshëm në fashtë për shkak të bashkëpunimit me serb, ata jetojnë në Gjermani dhe kanë ikur bashkë me serbët në vitin 1999. Unë mbas lufte atë tokë e kam punuar sepse ka qenë tokë e gjyshit tim deri para 5 viteve, mirëpo kanë qu fjalë mos me punuar më se ka punuar dhe asn nuk ka qenë i interesuar me ble. Më vonë e ka punuar një komshi, ndërkaq prej 2018 e punon vëllai i B. t H. dhe atë tokë e punojnë 2 serb te fshatit dhe ata nuk i nguc kurrkush. Pasi që është lajmëruar rasti në polici me ka thirrur hetuesi S. H. më ka kërkuar të bisedoj me të dhe arsyen do te ma tregon ne polici.

Ka shkuar në polici është intervistuar ne cilësi të dëshmitarit, ne deklaratat e tij H. ka deklaruar se nuk dyshon ne askënd, hetuesi me ka thënë se ju jeni nip e daj mos keni bërë marrëveshje që ky person me i marr letrat jashtë, unë i thash për shumë pare nuk isha hyrë në polici me i marr letrat dikush. Hetuesi me ka shti me i shkru 2-3 renda dhe më kat hënë se do ti ekzaminoj në frenzikë dhe me ha se më nuk do te ftoj. Hetuesi i merrke ka dy fjalë prej cdo letre dhe kam shku edhe me të shtypit dhe me të shkrimit polici ka qenë në një qosh unë në qoshin tjetër, ai diktojke unë shkrujsha disa fjalë nuk mujke mi lexu te pa kuptimta, mbas një muaj më ka thirrur Hetuesi dhe më ka thënë kërkoi falje se të kam thënë se nuk të thirri por duhet me ardh prapë, më ka thënë se daja e ka ndërruar deklaratën dhe ka thënë se meqenëse nuk po tregon se kush është prej fshatit atëherë i ki shkru letrat vet. Më ka pyet per dhondurt e tij kush janë dhe më kënd kanë bashkëpunuar, unë i thash kanë bashkëpunuar me shikoje me R. K. që ka bërë shumë krime në lufte dhe një vëllai i tij është vrrarë gjatë luftës ata kanë qenë famije e madhe. Hetuesi më ka liruar dhe me tha shko, nuk do te thirri më dhe më tha se në Forenzikë të Pejës nuk janë përputh shkrimet me ty, prapë më ka thirr dhe më ka shti me i shkru shkronjat me të shtypit dhe të shkrimit dhe ai prapë lexojke unë shkrujsha dhe me tha se duhet me i qu letrat në Prishtinë a pranon i thash po pranoj. 3 herë me ka thirr hetuesi S. H. dhe me ka shti me i shkru letrat.

I njëjti ka mohuar fajësin edhe me rastin e dhënies së deklaratës në Stacion Policorë në Pejë me dt20.06.2017.

Fjala përfundimtare

Prokurorja e shtetit ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se fillimisht beje precizimin e aktakuzës meqenëse edhe sot e pranova ekspertizën grafologjie nga e cila rezulton se faqet me nr. 13 dhe 14 përmbajtën në këto faqe nuk janë konstatuar se janë shkruar nga këtu i akuzuari por dorëshkrimet nga faqja 4 dhe 9 shihet qartë se këtu i akuzuari Sh. Q. i ka shkruar fjalë me përmbajtje kanosëse këtu të dëmtuarit H. Z., ashtu që në bazë të lartcekurave e bëjmë përmirësimin e diapozitivit te aktakuzës në këtë mënyrë:

“Që nga muaji gusht i vitit 2016 e gjerë me dt. 15.06.2017 rreth orës 20.30 minuta në fsh. K, pikërisht në shtëpinë e të dëmtuarit me qëllim të frikësimit, përmes letrave me përmbajtje kanosëse seriozisht kanos te dëmtuarin H. Z. në atë mënyrë që i pandehuri i dërgon të dëmtuarit tek dyert e oborrit te shtëpisë së tij letra me fjalë kanosëse “se ki me u likvidu ti me anëtarët e familjes tande” dhe sipas një letre tjetër të dërguar “këna me ta marr shpirtin” te cilat veprime te pandehurit tek i dëmtuari kanë shkaktuar frikë, pasiguri se me të vërtetë do i ndodh diçka e keqe nga i pandehuri”.

Me çka ka kryer vepër penale të Kanosjes nga neni 185 par. 2 të KPRK-së

Ne bazë të këtyre provave e në veçanti te ekspertizës grafologjie te dt. 08.08.2019 gjejmë se këtu i pandehuri Sh. Q. me veprimet e tij ka përmbush te gjitha elementet e veprës penale të kanosjes nga neni 185 par. 2 të KPRK-së, duke e shkaktuar edhe pasojën e kësaj vepre penale siq është shkaktimi i frikës tek i dëmtuari H. Z.. Këto përmbajtje kanosëse janë serioze që e plotësojnë kushtin themelor te figurës së kësaj vepre penale. Andaj, i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, ku me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin te merr parasysh si rrethanë renduese faktin se kjo kanosje ka vazhduar brenda një periudhe të caktuar kohore dhe ka krijuar pasiguri te madhe jo vetëm për këtu te dëmtuarin por edhe per anëtarët e afërm të familjes së tij.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit av. Gëzim Kollqaku në fjalën përfundimtare deklaron se në tërsi pajtohem me fjalën përfundimtare te prokurores së shtetit me c’rast sipas provave materiale nga prova 4 dhe 9 ka gjetur se ka kërcënime te mjaftueshme që janë bërë nga ana e të pandehurit ne drejtim te dëmtuarit dhe familjes së tij, por dua të shtoj se përveç provës 4 dhe 9 kërcënime ka edhe ne provën nr. 1 ku thuhet se “edhe një anëtar me i vogël vjen sot e mbrapa te ju dijeni se keni me u likvidu”. Në provën nr. 2 thuhet “ nëse një anëtar e len aty, dije se e more ne qaf krejt familjen”, në provën nr. 5 “thuhet se mos e rreziko veten dhe anëtarët e familjes, në provën nr. 7 “keni pas me u likvidu komplet para 5 vite por fati juaj ka qenë se jeni kon ne një kerr....”. gjithashtu edhe ne provën nr. 10 thotë “ty me familje edhe ata kriminel se kena me ju q.... robt more gabel i thiut”. Konsideroj se përveç këtyre dy provave materiale edhe këto prova tjera tek i dëmtuari dhe familja e tij kanë manifestuar me stres dhe frik se një e keqe do ti ndodh e sidomos kur dihet fakti se i dëmtuari dhe familja e tij nuk e ka ditur se nga po vinë këto letra. Pra këto letra të dëmtuarit dhe familjes së tij i kanë shkaktuar dëme te mëdha e sidomos nenës së të dëmtuarit e cila është 81 vjeçare. I pandehuri edhe përkundër dy ekspertizave prapë se prapë e mohon se i ka dërguar këto 12 letra të cilat kanë dal se i njëjti i ka nënshkrua dhe ajo çka vlen te ceket është se krejt ngjarja rreth këtyre kërcënimeve me anë t letrave ka filluar ditën kur është qitur një table e dhëndërit te tij nga pronarët e asaj patundshmëria dhe te nesërmen është hekur dhe të nesërmen tjetër kanë filluar këto letra dhe kanë zgjatë deri në kohës kur i dëmtuari e ka lajmëruar policinë, dhe nga ajo ditë i dëmtuari asnjë letër nuk e ka marr. Andaj propozoj gjykatës që të gjitha këto gjete rreth frikësimit dhe

tjerave që i deklarova të merren si rrethana renduese dhe i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I dëmtuari ne fjalën përfundimtare deklaroi se e përkrahi fjalën e përfaqësuesit tim të autorizuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Zeqir Bërdynaj në fjalën përfundimtare deklaroi se me vjen mirë që prokurorja prej ngritjes së aktakuzës nuk e ka vërejtur por sot e vërejtë at që shpreha me parë, se në dorëshkrimet me dorë në faqen 13 dhe 14 nuk janë shkruar nga i mbrojturi im por nga dikush tjetër. Është fakt i pamohueshem se në raport ne mes te nipit dhe dajës këtu tani të akuzuarit Sh.dhe te “dëmtuarit” H. Z.. Marrëdhëniet kanë qenë të mira, por këto u përkeqësuan ne momentin kur dy dhëndurët e tij të cilët sipas letrave që janë në lëndë, ishin bashkëpunëtor te ngushtë gjatë kohës së fundit në Kosovë me ushtrinë serbe dhe bashkërisht me ta kishin marr veprime inkriminuese dhe mu për këtë konsideroi se para se te ngritje kjo aktakuzë prokurorja është dashur që të verifikoj se kush është H. Z. dhe dhëndurët e tij dhe veprimet e tyre inkriminuese. Po mos te ishte ashtu qytetaret e fshatitte cilët e kanë shkruar një peticion lidhur me ngjarjen dhe letrat e shkuara, se që të dy dhëndurët e tij kishin marrë pjesë bashkërisht me ushtrinë serbe ne kalljen e shtëpive, po thonë se edhe ne vrasje dhe dhunime, në momentin kur këta pas 14 vite janë kthyer ne Kosovë fshatarët kanë qenë të pezmatuar te revoltuar për krimet që kanë bërë dhe është diskutuar ne mbar te fshatit. Të njëjtin gjë e ka kuptuar nipi i tij dhe për ata e ka dërguar të afërmin e tij dhe te H.ë- M. Z. që ti tërheq vërejtje se dhëndurët e tij kanë qenë kriminel te luftës. Prandaj konsideron se me heqjen nga dispozitivii ne dorëshkrimet nr. 13 dhe 14 të cilat kanë qenë dilem se a ka fjal kanose a nuk ka. Në dispozitiv thuhet se ka me te vra dhe nuk është në asnjë dokument se ka met vra por kanë met vra, kjo dallon. Prandaj ne bazë të dispozitivave ligjore konsideron se tani me nuk ekziston kanosja e aq me tepër nga paragrafi 2 nuk ka të lënduar. Ne komentarin e Kodit Penal te R. se Kosovës në faqen 497 par. 1 në mënyrë eksplicite thuhet se “ për ekzistimin e ankesës thuhet që personi që i drejtohet ti behet e qartë se çfarë e keqe do ti ndodh si dhe që ai person ti shkaktot një të keqe, nëse një person vetëm i bënë me dije dhe ne rastin konkret i kanë bërë me dije, nuk paraqet vepër penale të kanosjes. Andaj i propozoj gjykatës që të mbrojturin tim ta liroj nga aktakuza se nuk ka veprime inkriminuese.

I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaroi se pajtohem me fjalën e mbrojtësit, nuk ka asgjë për te shtuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Pas nxjerrjes së provave materiale dhe vlerësimi të tyre një nga një dhe lidhmëni reciproke me njëra tjetrën, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike

Që nga muaji gusht i vitit 2016 e gjerë me dt. 15.06.2017 rreth orës 20.30 minuta në fsh. K, pikërisht në shtëpinë e të dëmtuarit me qëllim të frikësimit, përmes letrave me përmbajte kanosëse seriozisht kanos te dëmtuarin H. Z. në atë mënyrë që i pandehuri i dërgon të dëmtuarit tek dyert e oborrit te shtëpisë së tij letra me fjalë kanosëse “se ki me u likvidu ti me anëtarët e familjes tande” dhe sipas një letre tjetër të dërguar “këna me ta marr shpirtin” te cilat veprime te pandehurit tek i dëmtuari kanë shkaktuar frikë, pasiguri se me të vërtetë do i ndodh diçka e keqe nga i pandehuri.

Me çka ka kryer veprë penale të Kanosjes nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Provat që vërtetojnë gjendjen faktike

Gjykata gjendjen faktike e ka vërtetuar bazuar në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor të cekura si me lartë e veçanërisht në dëshminë e dëmtuarit H. Z.. I dëmtuari H. Z. ka deklaruar se Sh. i kishte dërguar disa herë fjalë ruju se kanë me të vra, ka qenë njeri ne bagrem dhe ka deshtë me të vra, kur ky e ka pyet se kush është ai person që ka deshtë me të vra ai nuk i ka tregu me arsyen se nuk guxon se duhet me leshu fshatin. Pastaj ky i ka thënë se po gënjen ngase atë ditë ky nuk ka qenë tek toka por ka qenë në punë tu i vozitë nxënësit. I njëjti këtë e ka bërë me frikësuar dhe pastaj bëjnë çka donë me tokën e dhëndurëve te tij përkatësisht kushërinjve te tij. Mbas disa ditësh i kanë filluar letrat kërcënuese dhe prej kur e ka lajmëruar rastin ne polici letrat nuk ju janë dërguar më.

Gjykata dëshmisë së të dëmtuarit ja fali besimin dhe mori për bazë me rastin e vendosjes së kësaj çështje edhe pse i njëjti nuk e din se kush saktësisht i ka dërguar letrat, i njëjti qartë shpjegon se nga kusht janë dërgaur fjalët pasi që ky nuk është bindur për fjalët e të akuzuarit se nga fshati kanë dashtë me vra. Po ashtu në momentin kur ky e ka lajmëruar rastin kanë pushuar dërgimi i letrave kërcënuese.

Gjykata e mori për bazë edhe deklaratën e dëshmitarit M. Z. i cili e konfirmoj faktin se letrat janë gjete në oborrin e të dëmtuarit e dy i ka pa edhe vet. Njëerën kur ia ka tregu fëmija qe e kan gjet ka qenë pa zarf e ka pas ermin për H. dhe e ka lexu, tjetra ka qenë në zarf e ka pa se është për H.dhe nuk e ka çel me e lexu.

Se letrat janë dërguar nga i akuzuari është vërtetuar në bazë të ekspertizës së grafologjisë nga e cila rrjedh se shkrimi me shkronja të shtypit në dëshminë 1 në faqet 1, 2, 3, 4, 5, 6 janë shkruar nga personi i njëjtë me mostrat në dëshminë 2 (mostrat e marra nga i akuzuari).

Në bazë të rezultatit të ekspertimit se shkrimi në shkronjat e dorës në dëshminë 1 në faqet 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 është shkruar nga mostrat e njohura të shkrimeve nga materiali në dëshminë 2.

Po ashtu ekspertja e grafologjisë L. Sh. në mënyrë të qartë para gjykatës ka sqaruar ekspertizën dhe e ka mbetur pranë mendimit të dhënë me shkrim.

Pasi që është kontestuar nga palët përkatësisht mbrojtësi i të akuzuarit marrja e mostrave nga polici hetues, gjykata serish e në prezencë të ekspertëve të grafologjisë në gjykatë ka ftuar te pandehurin dhe në prezencë edhe te mbrojtësit të tij ka marr mostrat e dorëshkrimeve nga ai, duke i diktuar disa tekste të shkrimit dhe te shtypit, pastaj i është lënë mundësia që edhe vet të shkruaj sipas mendimit te lirë me shkrim dhe me shkronja të shtypit ku gjithsejtë janë marr 8 fleta me dorëshkrime, dhe serish ka urdhëruar ekspertizë re grafologjie nga eksperti tjetër.

Nga ekspertiza grafologjike e dt. 09.09.2019 rrjedh se dorëshkrimet me përmbajtje kërcënuese të evidentuara në dëshminë 1 janë shkruar nga personi i njëjtë me mostrat e njohura të dorëshkrimeve në dëshminë 2, (dorëshkrimet e marra nga i akuzuari në polici) dhe dëshminë 3 (dëshmitë e marra në gjykatë nga i akuzuari), përputhen me shkronjat e mëdha të shtypit në faqet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 dhe shkronjat e dorës – shkrimit në faqet 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12. Ndërkaq nuk ka përputhje me shkrimet si në faqet 12 dhe 13 të dëshmisë 1.

Gjykata bazuar në këto dy ekspertiza si dhe deklaratiën e të dëmtuarit H. Z. dhe M. Z. ka vërtetuar se i akuzuari është kryes i veprës penale nga neni 185 par 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Vepra penale e vërtetuar dhe elementet e saj

Neni 185 parasheh:

1. Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

2. Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t'i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Gjykata pas vlerësimit të kësaj dispozite ligjore në raport me provat e administruara të cilat i mori për bazë me rastin e vendosjes së kësaj çështje, vlerësoi se në rastin konkret janë përmbush elementet e veprës penale nga neni 185 par.2 lidhur me nenin1 të KPRK-së. Kjo vepër penale është kryer nga i akuzuari me qëllim të frikësimit dhe që i njëjti mos të kujdeset për pronat e dhëndurve të tij që gjinden në fshatin Komuna

Gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtonin përgjegjësin penale të akuzuarit andaj i njëjti është penalisht përgjegjës, andaj e shpalli fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Gjykata e vlerësoj mbrojtjen e të akuzuarit dhe të njëjtën e hodhi poshtë si të pa bazuar dhe të bërë me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, pasi që bie në kundërshtim me provat e tjera në shkresat e lëndës.

Provat që nuk janë marr për bazë

Gjykata i ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve N. K., A. A., M. Z.. Të njëjtit në dëshmitë e tyre, përshkruajnë personalitetin e të dëmtuarit dhe dhëndurve të dëmtuarit dhe rrolin e tyre gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ndërkaq, lidhur me rastin në fjalë e mohojnë faktin që i akuzuari ti ketë shkruar letra kërcënuese të dëmtuarit. Deklaratat e këtyre dëshmitarëve gjykata nuk i mori për bazë sepse ishin në kundërshtim me provat tjera të administruara.

Gjykata nuk i ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit A. Z. dhe F. A. pasi që të njëjtit nuk mbetën pranë propozimit në seancat e rrudhës dhe kanë propozuar dëshmitar të tjerë.

Rrethanat për dënimin

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KP të Republikës së Kosovës, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari pati sjellje korrekte

para gjykatës dhe për gjykatën nuk ka të dhënë se i njëjti ka ra në konflikt me ligjin. Nga rrethanat rënduese nuk gjeti asgjë.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se këto dënime janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë siç është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

I dëmtuar u udhëzua në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike konform nenit 463 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e gjyqësore është marrë konform nenit 450 të KPPR të Kosovës.

Vendimi për viktimat e krimit

Konform nenit 39 par.1,2,3 nen par.3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit e obligoj me pagesën e taksës si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e theksuara si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:051472, 17.01.2020

G j y q t a r i

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.